



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 391 Prot.

Tiranë, më datë 10 .10 .2019

VENDIM

Nr. 322, datë 10.10.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, pas shqyrtimit më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 10.10.2019,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Llogaritjet strukturore të projektimit të themelit nën konstruksionin metalik të “Xhamia e Et’hem Beut””, Tiranë, me subjekt aplikues shoqëria “KALE”, me sugjerimet:
 - Të përcaktohet plan-organizmi dhe grafiku i punimeve;
 - Nga konstruktori të bëhet detaji i çmontimit të strukturave betonarme e të strukturave metalike, shoqëruar me relacion teknik përkatës për të gjitha detajet dhe të firmosura dhe vulosura nga projektuesit;
 - Të vendoset tabela informuese për zhvillimin e punimeve lidhur me çatinë provizore;
 - Territori të kthehet në gjendjen e mëparshme pas përfundimit të punimeve;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

